



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:150162
Datë: 29.03.2024
Numri i dokumentit: 05524516

PPP.nr.172/22

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni civil, gjyqtari Faton Ajvazi, me sekretaren juridike Makfire Reçica, në çështjen përmbartimore të kreditorit Nj.B. nga Ferizaj, të cilin me autorizim e përfaqëson av Gazmend Rexhepi nga Ferizaj, kundër debitorëve Sh.D. nga Prishtina, rr “...”, nr.... dhe B.D. nga Prishtina, rr “...”, të cilët me autorizim i përfaqëson av Ardita Gashi nga Prishtina, për pagesën e borxhit, duke vendosur për prapësimin e ushtruar nga i autorizuari i debitorëve, me datë 29.03.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I.PRANOHET pjesërisht prapësimi i të autorizuarit të debitorëve Sh.D. dhe B.D., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.232/2022, të datës 07.07.2022, i lëshuar nga Përmbartuesi Privat Sh.L. nga Ferizaj, sa i përket kamatës prej 7 %, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të kërkuar me propozim për përmbartim nga i autorizuari i kreditorit dhe **SHFUQIZOHET** urdhri për përmbartim P.nr.232/2022, i datës 07.07.2022 sa i përket kamatës prej 7 %, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

II.REFUZOHET si i pabazuar prapësimi i të autorizuarit të debitorëve Sh.D. dhe B.D., i ushtruar kundër urdhrin mbi lejimin e përmbartimit P.nr.232/2022, të datës 07.07.2022, sa i përket shumës së borxhit prej 4,020 euro dhe për shpenzimet e procedurës së përmbartimit dhe **MBETET NË FUQI** urdhri mbi lejimin e përmbartimit P.nr.232/2022, i datës 07.07.2022, për shumën e borxhit prej 4,020 euro dhe për shpenzimet e procedurës së përmbartimit.

A r s y e t i m

Me urdhrin P.nr.232/2022, të datës 07.07.2022, Përmbartuesi privat Sh.L., e ka caktuar përmbartimin e propozuar nga i autorizuari i kreditorit Nj.B., kundër debitorëve Sh.D. dhe B.D., për përmbartimin e aktgjykimit P.nr.3214/17, të datës 07.04.2022, i lëshuar nga Gjykata Themelore në Ferizaj, për pagesën e borxhit në shumë prej 4,020, euro, me kamatë prej 7% nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, si dhe pagesën e shpenzimeve të procedurës së

përmbarrimit ose ndalimin e mjeteve në para nga llogaritë bankare të debitorëve nëpër të gjitha bankat komerciale në Kosovë dhe bartjen e tyre në llogarinë e veçante të përmbarruesit privat.

Kundër urdhrimit për lejimin e përmbarrimit, i autorizuari i debitorëve, brenda afatit ligjor, ka ushtruar prapësim, me të cilin i ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin si të bazuar dhe ta shfuqizoj urdhrin për përmbarrim.

I autorizuari i kreditorit, në përgjigjen e ushtruar me shkrim, në prapësimin e të autorizuarit të debitorëve, i ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorëve si të pabazuar dhe të mbetet në fuqi urdhri për përmbarrim.

Gjykata i shqyrtoj shkresat e lëndës, urdhrin për përmbarrim dhe pretendimet në prapësim të autorizuarit të debitorëve dhe vlerësoj se:

Prapësimi është pjesërisht i bazuar.

Gjykata vlerëson se urdhri për përmbarrim P.nr.232/2022, i datës 07.07.2022, i lëshuar nga Përmbarruesi privat Sh.L., është pjesërisht i ligjshëm dhe i rregullt, përkatësisht është i ligjshëm sa i përket shumës së borxhit prej 4,020 euro dhe për shpenzimet e procedurës së përmbarrimit, kurse nuk është i ligjshëm sa i përket kamatës së kërkuar nga i autorizuari i kreditorit prej 7 %, nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Sa i përket pretendimit të autorizuarit të debitorëve në prapësim se kreditori urdhrimit për përmbarrim i ka bashkangjitur vetëm kopjen e aktgjykimit P.nr.3214/17 dhe sipas LPP-së, nenit 37 dhe 40, par 1, pika 1.3, propozimi për përmbarrim i kreditorit duhet ta ketë të bashkangjitur si provë dokumentin origjinal ose kopjen e vërtetuar sipas ligjit, Gjykata këtë pretendim e konsideron të pabazuar dhe të pa qëndrueshëm, sepse nga shkresat e lëndës, gjegjësisht nga aktgjykimi P.nr.3214/17, i datës 07.07.2022, konstatohet se Përmbarruesi privat Sh.L., me rastin e nxjerrjes së urdhrimit të atakuar me prapësim, të njëjtin e ka nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 36, par 1, të LPP-së, për shkak se aktgjykimi i cekur më lart siç shihet është në origjinal të tij e jo siç pretendon i autorizuari i debitorëve në prapësim se aktgjykimi në fjalë është në kopje.

Përveç tjerash, Gjykata konstaton se përmbarruesi privat Sh.L., me rastin e nxjerrjes së urdhrimit për përmbarrim P.nr.232/2022, të datës 07.07.2022, është bazuar në nenin 22, par 1, nën par 1.1, të LPP-së, sepse në dispozitën ligjore të cekur më lartë është përcaktuar shprehimisht se si dokument përmbarrues në bazë të cilit organi përmbarrues e cakton përmbarrimin konsiderohet edhe aktgjykimi i lëshuar nga gjykata, siç është në rastin konkret aktgjykimi P.nr.3214/17, i datës 07.07.2022, i cili e përmban klauzolën e përmbarrueshmërisë për përmbarrueshmëri, e paraparë në nenin 36, par 1, të LPP-së.

Gjithashtu, gjykata konstaton se aktgjykimi i cekur më lart është në tërësi i përshtatshëm për përmbarrim dhe në pajtim me nenin 27, par 1, të LPP-së, pasi që në të është

treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, mjetet, shuma e cila është prej 4,020 euro dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata me rastin e pranimit të prapësimit të autorizuarit të debitorit sa i përket kamatës prej 7% nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të kërkuar me propozim për përmbarim nga i autorizuari i kreditorit, është bazuar në aktgjykimin P.nr.3214/17, të datës 07.04.2022, në të cilin përveç shumës së mjeteve prej 4,020 euro, që janë detyruar debitorët që t'ia paguajnë kreditorit, nuk është paraparë që këtë shumë të mjeteve të njëjtit ta paguajnë edhe me kamatën prej 7% siç e ka kërkuar i autorizuari i kreditorit.

Andaj, Gjykata duke i marr parasysh thëniet e të autorizuarit të debitorëve në prapësim, përgjigjen me shkrim të autorizuarit të kreditorit në prapësimin e debitorëve, provat dhe shkresat tjera të lëndës, konstatoj se prapësimi i të autorizuarit të debitorëve sa i përket shumës së mjeteve prej 4,020 euro dhe për shpenzimet e përmbarimit është i pabazuar dhe për këtë pjesë vendosi që të mbetet në fuqi urdhri për përmbarim, kurse është i bazuar prapësimi sa i përket kamatës prej 7% nga dita e plotfuqishmërisë së aktgjykimit, të kërkuar me propozim për përmbarim nga i autorizuari i kreditorit dhe për këtë pjesë gjykata e shfuqizoj urdhrin për përmbarim.

Nga të cekurat më lart dhe bazuar në nenin 73, par 1, 2 dhe 3, të LPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
PPP.nr.172/22, më datë 29.03.2024

GJYQTARI
Faton Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate, në afatin prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktvendimi.